



Nr. Prot. 021/B/11

VENDIM Nr. 80

Miratimi i tarifave për licencim të operatorëve postar dhe vendosja e tarifës së rregullt vjetore (One-off-fee) për operatorët e Shërbimeve Postare

Në bazë të nenit 6 pika 1.5 dhe nenit 26 pika 1 dhe 2 të ligjit nr. 03/L-173 për Shërbime Postare dhe nenit 4 paragrafi (4) dhe nenit 6 paragrafi (1), të Ligjit për Telekomunikacionin Nr. 2002/7 i ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-085, Bordi i Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit (ART) në përbërje:

- 1) z. Ekrem Hoxha Kryetar
- 2) z. Besnik Berisha Anëtar,
- 3) z. Lulzim Kurtaj Anëtar,
- 4) z. Naser Shala Anëtar,
- 5) z. Nijazi Ademaj Anëtar,

në mbledhjen e datës 8 Prill, 2011, konform procedurave të përcaktuara me dispozitat e ligjeve bazë dhe rregulloren e brendshme të ART-së, merr këtë:

V E N D I M

- I. Miratohen tarifat për licencim të operatorëve postar për territorin e Republikës së Kosovës si në vijim;

<i>Nr.</i>	<i>Lloji i licencës / shërbimit</i>	<i>Kohëzgjatja</i>	<i>Tarifa €</i>
1	Shërbime brenda RKS dhe Ndërkombëtare,	10 vite	2,500.00
2	Shërbime brenda RKS (Ekspres, Korrier, shërbime tjera),	10 vite	1,500.00
3	Ndryshimi i të dhënave në Licencë (me kërkesë të palës)		200.00

- II. Miratohet vendosja e tarifës së rregullt vjetore (One-off-fee) në lartësi prej **0.5%** për të gjitha shërbimet postare të ofruara nga operatorët e licencuar postar.
- III. Skema e re e tarifave të specifikuar në dispozitivin e nenit I do të aplikohen nga dita e miratimit nga Bordi i ART-së, dhe do të jenë të aplikueshme deri në një vendim të ri nga Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit (ART).

- IV. Tarifa e specifikuar në dispozitivin e nenit II, do të aplikohet në baza vjetore duke filluar nga data 01.01.2011, dhe atë në bazë të qarkullimit vjetor bruto nga veprimtaria e licencuar për vitin paraprak..
- V. Të gjithë operatorët ofrues të shërbimeve postare janë të obliguar që ART-së ti paraqesin/dorëzojnë raportin vjetor të pasqyrave financiare të bazuar në revizionin e pavarur dhe atë JO më vonë se tre muaj pas përfundimit të vitit fiskal për të cilin është kryer revizioni gjegjësisht raporti.
- VI. Të gjithë ofruesit potencial ose aplikantët për licencë, duhet të paguajnë një shumë të caktuar në emër të tarifës për procesim të aplikacionit. Shuma e tarifës për procesim të aplikacionit do të jetë pesëdhjetë (50) Euro për të gjitha licencat individuale, përveç nëse është e caktuar ndryshe me pako tenderuese për tender publik.
- VII. Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit (ART), rezervon të drejtën që në të ardhmen të ndryshoj këtë vendim, nëse e sheh të arsyeshme, konform ligjeve të aplikueshme në Republikën e Kosovës dhe për çdo ndryshim në lidhje me vendimin, do informoj me kohë palët e interesit.
- VIII. Ky vendim hyn në fuqi dhe do të aplikohet nga dita e miratimit të tij nga Bordi i ART-së.

BAZA LIGJORE

- 1) Neni 6 pika 1.5, e ligjit nr. 03/L-173 për Shërbime Postare, autorizon Rregullatorin /Autoritetin Rregullator të Telekomunikacionit (ART), të përcaktoj tarifat për dhënien e licencave dhe tarifën e rregullt vjetore (One-off-fee) për ofrimin e shërbimeve postare, dhe afatet për kryerjen e pagesave;
- 2) Neni 26 pika 1 e këtij ligji, obligon operatorët postar të paguajnë taksën / tarifën e rregullt vjetore (One-off-fee) për licencë zyrës së Rregullatorit /Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit (ART);
- 3) Neni 26 pika 2, i mundëson Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit (ART), nxjerrjen e këtij vendimi, përcaktimin e shumës së pagesës, formën dhe afatin kohor dhe çështjet tjera që lidhen me pagesën e tarifës së rregullt vjetore (One-off-fee);
- 4) Në përcaktimin e këtyre tarifave Autoritetit Rregullator i Telekomunikacionit (ART), ka marrë parasysh rekomandimet sipas Direktivave të BE-së, përkatësisht Direktivës 97/67 /EC, dhe Direktivës 2008/06 /EC, si dhe janë marrë parasysh praktikat më të mira të vendeve të rajonit dhe disa vendeve të Bashkimit Evropian.

Këshilla Juridike

Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk lejohet ankesa. Ky vendim u nënshtrohet çfarëdo shqyrtimi përmes procedurave administrative gjyqësore të parapara me ligjet në fuqi.

Vërtetim

Më këtë vendim konfirmohet se Bordi i ART-së ka vendosur në pajtueshmëri me rregulloret dhe ligjet e aplikueshme në Kosovë, dhe në pajtueshmëri me rregullat e procedurës së ART-së.

Prishtine, 18/04/2011

Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit

Ekrem Hoxha
Kryetar i Bordit

Besnik Berisha	Anëtar i Bordit
Lulzim Kurtaj	Anëtar i Bordit
Nijazi Ademaj	Anëtar i Bordit

Aktvendimi i dërgohet:

- Operatorëve të Licencuar të Shërbimeve Postare në Republikën e Kosovës;
- Ministrisë së Infrastrukturës, QeK
- Zyrtarit të Larte të Shërbimeve Postare, ART dhe
- Arkivit të ART-së.